



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



INCIDENTET ME EKSPLOZIVA NË SHQIPËRI 2017-2022

AUTOR

Foto Duro

Dhjetor 2022

Mirënjohje

Dëshiroj të shpreh falënderimet më të veçanta ndaj miqve të mi, Gjeneralmajor Qemal Shkurti dhe Armando Guçe, për idetë dhe këshillat e tyre, të cilat u përpoqa t'i reflektoja të gjitha në këtë studim, gjithashtu për vërejtjet e tyre mbi draftin e parë. Kombinimi i grafikëve të eksplozivave të shpërthyer dhe atyre të kapura, në një paraqitje të vetme grafike, sugjeruar nga Gjeneral Shkurti, ishte me vlerë të veçantë në nxjerrjen e përfundimeve të rëndësishme në lidhje me marrëdhëniet midis këtyre dy dukurive, dhe vënien nën kontroll të sulmeve me eksploziva në Shqipëri.

Përmbajtja

Shkurtesat	3
Përmbledhje	4
Hyrje	5
Sulmet me eksploziva në Shqipëri	7
Eksplozivat e kapura	13
Përfundime	17
Rekomandime	19
Bibliografi	20
Shtojca 1: Sulmet me eksploziva në Shqipëri (01.06.2017 – 10.12.2022)	21
Shtojca 2: Eksplozivat e kapura në Shqipëri (01.05.2017 – 10.12.2022)	23

Shkurtesat

ALZ	Agjenci ligj zbatuese
C4	Eksplziv i fuqisë së lartë që falë përbërjes kimike është plastik dhe mund t'i jepet forma e dëshiruar
EOD	Heqje e eksplozivit dhe municionit (Explosive Ordnance Disposal)
GKO	Grup i krimit të organizuar
Q	Tremujor (Quarter)

Përmbledhje

Studimi vijues fokusohet i gjithi në incidentet me eksploziva të ndodhura në Shqipëri gjatë periudhës prej qershorit 2017 deri në fillim të dhjetorit 2022. Pasi thekson potencialin që ka, përdorimi i eksplozivave për qëllime kriminale apo terroriste, për të shkaktuar dëme të mëdha ndaj objektivave të tyre (qofshin ata individë, biznese, apo institucione) por edhe ndaj sigurisë të vendit në përgjithësi, studimi analizon karakteristikat e incidenteve me eksploziva në Shqipëri, nga aspekti i teknikave më të preferuara të përdorura nga keqbërësit, shpërndarjes gjeografike të tyre, objektivave të zgjedhura, etj. Nga ana tjetër, rastet e eksplozivave të kapura si dhe personat posedues të tyre të arrestuar, përbën një fushë tjetër me shume interes, të trajtuar në këtë studim, jo vetëm për shkak të përmasave të këtij fenomeni, teknikave të trafikantëve, e të preferencave për llojin e pajisjeve shpërthyes në treg, por edhe për një marrëdhënie të zhdrejtë, kundër-qëndruese, që spikat dukshëm, (mbështetur statistikisht në studim) ndërmjet rasteve të eksplozivave të shpërthyer dhe atyre të kapura nga policia.

Në vijim, ndryshe nga raportet zyrtare, të cilat për më tepër mbeten jo të plota, të dhënat e paraqitura në studim, sugjerojnë një tendencë të lehtë rritës të incidenteve me eksploziva në Shqipëri (të shpërthyer apo të kapura) gjë të cilën agjencitë ligj zbatuese (ALZ) duhet ta konsiderojnë seriozisht e të angazhohen më mirë. Pjesa e fundit e studimit konsiston në rekomandimet për masat e nevojshme që duhet të ndërmerren nga organizatat shtetërore e private me qëllim rritjen e sigurisë të personelit të tyre dhe popullsisë në tërësi.

Hyrje

Në të shkuarën, deri në vitin 2015, një numër dokumentesh të institucioneve ndërkombëtare, paraqisnin një tendencë rritëse të përdorimit të eksplozivave në Shqipëri, veçanërisht, eksplozivave të aktivizuara në distancë, të vendosura në automjetet apo banesat private, të cilat arrinin një kulm prej 72 shpërthimesh, të ndodhura vetëm në vitin 2015¹. Në disa dokumente të tjera zyrtare të institucioneve shqiptare pranohej: “[...] gjatë 2017 [...] u konstatua që grupet kriminale po përdorin në mënyrë të shtuar eksplozivat e aktivizuara në distancë, për të mbrojtur aktivitetin e tyre dhe eliminuar rivalët”².

Në vitet vijues pati një farë suksesi nga ALZ-të, kundrejt përdorimit të paligjshëm të eksplozivave. Megjithatë, në vitin 2019 u raportuan 37 sulme të tilla, me një rënie në 25 sulme në vit, në të dy vitet pasues, për t’u ngritur përsëri në 35 sulme me eksploziva në vitin 2022 (deri në 10 dhjetor)³. Një nivel i tillë, së bashku me rastet e kapjes së ngarkesave shpërthyes, tregon se eksplozivat mbeten “*mjaft në modë*” në Shqipëri, një shqetësim serioz për sigurinë për ALZ-të dhe bizneset. Për disa vite rresht, sulmet me eksploziva në Shqipëri ishin pjesë e raporteve të organizatave kombëtare e ndërkombëtare, pastaj, duke filluar nga 2018, eksplozivat nisën gradualisht të mungonin në këto raporte, pavarësisht se këto incidente vijuan të ndodhnin e gjithashtu të përmendeshin në media. Mesa dukej, për shkak të dëndurisë të këtyre rasteve, por edhe të faktit që incidentet me eksploziva në Shqipëri janë relativisht jo të profilit të lartë, po krijohej një farë “familjarizimi” me to, jo vetëm në opinionin publik por edhe në agjencitë e specializuara.

Nga ana tjetër, raportet zyrtare shqiptare në këtë aspekt mbeten fragmentarë, të fokusuar më shumë në progresin (megjithëse shpesh i vogël) në krahasim më të shkuarën, duke mos mundur të japin një pamje të qartë e t’u përgjigjen pyetjeve në lidhje me këto incidente në Shqipëri, si p.sh, shkalla e këtyre ngjarjeve, tendenca e vlerësuar, efekti i tyre real në sigurinë e vendit në përgjithësi, rajonet më të goditura në këtë aspekt, etj. Një element shumë i rëndësishëm që mbetet i mangët, deri i shmangur plotësisht, në këto raporte është “post-incidenti”. Kështu, në rastet e eksplozivave të shpërthyer, shumë rrallë keqberësit janë identifikuar dhe arrestuar. Në shumicën e rasteve të tilla, fraza standarde që mbyll raportet e policisë është: “*ekspertët po punojnë për zbardhjen e detajeve të ngjarjes...*”.

Nisur nga kjo situatë, autori i këtij studimi filloi të regjistronte në mënyrë të pavarur çdo incident që kish lidhje me eksplozivat (të shpërthyer apo të kapura nga policia) siç raportoheshin në media, për një periudhë kohe prej 1 qershorit 2017 deri më 10 dhjetor 2022. Për rrjedhojë, u krijuan dy baza të dhënash të veçanta, për eksplozivat e ekzekutuara dhe ato të kapura nga policia. Kështu, ndërsa ndonjë incident i veçantë mund të ketë kaluar po u vënë re, “i fshehur” në morinë e lajmeve të tjera, incidentet e tjerë (pjesa dërmuese, në mos jo të gjithë) u regjistruan me kujdes. Në këtë mënyrë, u mblodh një sasi shumë e madhe të dhënash (shtojcat 1 dhe 2 në fund përfaqësojnë një version paksa të thjeshtësuar të bazave origjinale të të

¹ Departamenti i Shtetit i ShBA (OSAC) Albania 2016 Crime and Safety Report (tashmë i pa disponueshëm më në internet).

² “Strategjia e kontrollit të armëve të vogla dhe të lehta, municioneve të tyre dhe eksplozivave, 2019-2024, Anglisht”, f.9. https://www.seesac.org/f/docs/Albania-1/ENG_Albanian_Strategy_on_Firearms_Control-24-06-2019.pdf

³ Për më shumë detaje në lidhje me rastet e përdorimit apo kapjes së eksplozivave në Shqipëri shih shtojcat 1 dhe 2 në fund.

dhënave) duke bërë të mundur një analizë më të thelluar, si dhe nxjerrjen dhe ofrimin e përfundimeve dhe rekomandimeve përkatëse.

Sulmet me eksploziva në Shqipëri

Tabela më poshtë (fig.1) duke sintetizuar një pjesë të bazës të të dhënave, të përmendur më herët, mundëson një pamje të përgjithshme sasiore të incidenteve me eksploziva të ndodhura në Shqipëri gjatë periudhës 1 qershor 2017 – 10 dhjetor 2022 (65.5 muaj). Bazuar në këto të dhëna, mund të konstatohet lehtë që frekuenca e këtyre incidenteve është rreth 3.5 në muaj (prej të cilave 2.4 eksploziva të shpërthyer, ndërsa në rreth 1.1 raste në muaj, tentativa ka dështuar, për shkak se ngarkesa e eksplozivit/eksplozivave e përgatitur për t'u përdorur diku, u kap nga policia gjatë transportit). Në mungesë të të dhënave të ngjashme në vende të tjera, është vështirë të bëhen vlerësime të krahasueshme për çka ato përfaqësojnë për Shqipërinë. Pavarësisht nga kjo, në mënyrë intuitive, mund të konsiderohet që, për një vend me popullsi të vogël si Shqipëria⁴, këto shifra përbëjnë një shqetësim serioz sigurie.

Në mbështetje të këtij përfundimi mund të shërbejë edhe fakti që gjatë periudhës të analizuar ka pasur pesë raste ku, në të njëjtin rajon, gati në të njëjtën kohë, kanë ndodhur dy shpërthime eksplozivi (shih

	2017			2018			2019			2020			2021			2022 (10 Dhj)			TOTAL		
	Incidente	Vdekje	Plagosje	Incidente	Vdekje	Plagosje	Incidente	Vdekje	Plagosje	Incidente	Vdekje	Plagosje	Incidente	Vdekje	Plagosje	Incidente	Vdekje	Plagosje	Incidente	Vdekje	Plagosje
Shpërthyer	5	0	0	28	0	9	37	1	3	25	0	3	27	1	3	35	1	2	157	3	20
Dështu/kapur	4			15			10			12			17			16			74		
TOTAL	9			43			47			37			44			51			231		

Fig. 1. Incidentet me eksploziva në Shqipëri (1 Qershor 2017 – 10 Dhjetor 2022)

Shojca 1). Konkretisht: në Vlorë më 02.05.2018 (2 shpërthime në 45min); Fushë-Krujë, më 31.01.2019 (2 shpërthime në 30min); Shkodër, më 5 Janar 2020 (2 shpërthime në 2 orë) dhe 26.03.2022 (2 shpërthime gati njëkohësisht); Tiranë, më 10 Gusht 2022 (gjithashtu 2 shpërthime gati të njëkohshme).

Këto raste, si dhe fakte të tjera të dhëna më poshtë dëshmojnë për një farë preference ndaj eksplozivave si “armë e zgjedhur”, për “larjen e hesapeve” në Shqipëri. Arsyet për këtë janë të ndryshme, por sidomos ato lidhen me vetë natyrën e eksplozivave (si armë):

Së pari, është shumë e vështirë të parandalosh sulmet me eksploziva dhe është akoma më e vështirë të zbulosh e ndjekësh autorët e këtyre sulmeve, për shkak se provat materiale të lëna pas janë minimale. Zakonisht ato shkatërrohen bashkë me shpërthimin.

Së dyti, akte të tilla kanë efekte të konsiderueshme dhe të menjëhershme. Ato janë të natyrës fizike e psikologjike. Eksplozivat mund të shkatërrojnë në çast jetën personale, ekonominë dhe në rastin e shënjestrimit të bizneseve, përveç humbjeve njerëzore dhe/ose materiale, mund të dëmtojnë edhe reputacionin e tyre – të gjitha këto pasoja janë zakonisht pjesë e qëllimit të keqbërësit.

Së treti, ato mund të shkaktojnë dëme kolaterale në jetë njerëzore dhe pronë. Individët apo objektet të cilat mund të mos ishin objektivi direkt i shpërthimit, mundet gjithashtu të pësojnë

⁴ Sipas INSTAT, popullsia e Shqipërisë një Janar 2022 ishte rreth 2.8 milionë banorë, <http://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/popullsia/publikimet/2022/popullsia-e-shqip%C3%ABris%C3%AB-1-janar-2022/>

dëme serioze. Kjo e bën shpesh të vështirë të përcaktohet se cili ka qenë objektivi real i sulmit, duke e komplikuar më tej hetimin e ndërmarrë nga ALZ-të.

Së fundi, këto lloj sulmesh kanë aftësinë të përhapin frikë për sulme të (mundshme) të tjera vijuese. Si të tilla, ato mund të aplikohen me “sukses” nga grupet kriminale si një mjet frikësimi kundër grupeve rivale ose individëve. Nga ana tjetër, këto sulme mund të dekurajojnë punonjësit e bizneseve legjitime (qofshin ato si objektiv, objektiv i mundshëm, ose thjesht të perceptuara në rrezik për shkak të qenies fizikisht pranë të parëve) për të qëndruar apo larguar nga puna aktuale.

Për sa i përket humbjeve në njerëz të shkaktuara nga këto sulme, sikurse shihet në tabelë, ka pasur 3 vdekje në 3 sulme të veçanta, gjatë periudhës së analizuar, të cilat përbëjnë rreth 2% të të gjitha sulmeve me eksploziva, ndërsa në të gjitha rastet (157 në total) ka pasur 20 persona të plagosur, ose 12.8% të gjithë sulmeve. Natyrshëm vdekshmëria mund të kishte qenë më e lartë, duke pasur parasysh që për shkak të efektit të pakontrollueshëm të eksplozivave, pasi aktivizohen, të plagosurit (pa llogaritur subjekte të tjerë të ndodhur pranë) krejt rastësisht i kanë shpëtuar vdekjes. Nga ana tjetër, në 3 raste, ngarkesat plasëse të vendosura nën makinat ose banesat e personave-shënjestër, u zbuluan rastësisht në kohë dhe u asgjësuan me shpërthim të kontrolluar, nga grupet EOD⁵ (konkretisht në Durrës, më 19.11.2018; në Vlorë, më 31.01.2019 dhe Rrëshen, më 06.05.2019). Mund të supozohet që pasojat do të kishin qenë më të rënda nëse keqbërësit do të kishin pasur sukses në aktin e tyre.

Tabela e sulmeve me eksploziva (Shtojca 1) mundëson një analizë të mëtejshme për të nxjerrë përfundime të tjera. Kështu, eksplozivat janë përdorur kryesisht kundër bizneseve, por mbetet e paqartë, nëse motivet kanë qenë për shkak rivaliteti, si reaksion ndaj shqetësimeve të shkaktuara nga aktiviteti i këtyre bizneseve ndaj komunitetit, apo për presion me qëllim fitimi (“gjobë vënie”). Kështu, në 34 raste, ose 21.7% të gjithë sulmeve me eksploziva, objektivi kanë qenë bizneset (bare, dyqane, hotele). Pronat e oficerëve të policisë (zakonisht automjete) janë sulmuar në 10 raste⁶, automjetet e prokurorëve në dy raste⁷, banesat e aktivistëve të opozitës (anëtarë të Partisë Demokratike) në 3 raste⁸.

Nisur nga fakti që asnjë nga oficerët e policisë, prokurorët apo aktivistët e opozitës nuk u dëmtua gjatë këtyre sulmeve, ndërsa nga të gjithë bizneset objekt të sulmeve me eksploziva, vetëm në një rast pronari u plagos (A.A, Elbasan, 16.11.2018) mund të konkludohet që qëllimi i autorëve në të gjithë këto sulme, ka qenë më shumë për ta kërcënuar e shkurajuar objektivin, sesa për ta dëmtuar fizikisht. Nga ana tjetër ka të paktën dy raste kur sulmi me eksploziv është përsëritur ndaj të njëjtit objektiv. Kështu një biznes (hotel) në Sarandë, në pronësi të M.M. është sulmuar dy herë (respektivisht më 09.02.2021 dhe 20.06.2022) ndërsa banesa e A.P. në Fushë-Krujë është sulmuar tre herë (02.10.2020 dhe 09 Mars e 18 Prill 2021). Megjithatë, në të dy rastet (Sarandë, Fushë-Krujë) pasojat e sulmeve kanë qenë të lehta materiale.

Më 11.06.2020 një shpërthim i fuqishëm eksplozivi ndodhi në Tiranë, në orët e para të mëngjesit. Ngarkesa plasëse i ishte vendosur një restoranti në një rrugë qendrore të qytetit. Megjithëse nuk pati dëme njerëzore, restoranti u dëmtua rëndë, së bashku me dy biznese të tjera pranë tij. Policia mundi të arrestojë autorin, një person me rekorde të rënda kriminale⁹

⁵ EOD –Heqje e eksplozivave dhe municioneve (Anglisht: Explosive Ordnance Disposal)

⁶ Oficerët e policisë janë shënjestruar më 11.01.2018; 22.04. 2019; 05.01. 2020; 27.01. 2020; 03.09.2021; 23.04. 2022; 20.05. 2022; 02.06. 2022; 08.06. 2022 dhe 15.10. 2022 (Shtojca 1)

⁷ Automjetet e dy prokurorëve janë sulmuar me eksplozivë më 21.12. 2019 dhe 11.03. 2021 (Shtojca.1).

⁸ Aktivistë të opozitës janë shënjestruar më 08.08. 2019; 23.05. 2021 dhe 19.11. 2022 (Shtojca.1)

⁹ Syri.net (2020). Arrestohet autori i tritolit në lokalin pranë ‘Petro Ninit’/ Dëshmia në polici: Eksplozivi ishte porosi. E disponueshme në <https://www.syri.net/kronike/346846/arrestohet-autori-i-tritoli-ne-lokalin-prane-petro-ninit-deshmia-ne-polici-eksplozivi-ishte-porosi/>

dhe siç u raportua, motivi ishte rivaliteti në biznes. Sidoqoftë, prania e objektit në një zonë shumë të populluar të kryeqytetit, të patrulluar mirë nga policia dhe pranë disa prej institucioneve të larta të vendit, nuk e frenoi keqbërësin (dhe porositësin e supozuar) nga kryerja e këtij sulmi. Nga ana tjetër, dëmet serioze të pësuar edhe nga dy bizneset e tjera, në afërsi, tregojnë mundësinë e lartë të rënies viktime e rastësishme, e një sulmi me eksploziv, si “dëm kolateral”. Gjithashtu, bankomatet janë sulmuar me eksploziv, gjatë periudhës në analizë, në dy raste¹⁰, qartazi për përvetësim parash.

Dy kryetarë bashkish u bënë objekt i sulmeve me eksploziva, gjatë kësaj periudhe, i pari në Burrel (04.11.2017) ndërsa tjetri, në Lushnjë (31.12.2019). I dyti u sfidua hapur nga ish shoferi i tij, i cili hodhi një ngarkesë plasëse të improvizuar në zyrën e tij. Si rrjedhojë, kryetari i bashkisë dhe sekretarja e tij u plagosën nga shpërthimi i eksplozivit ndërsa sulmuesi u arrestua.

Vetëm në 12 raste (nga 157 raste sulme me eksploziva, pra në 7.6% të totalit) autori i shpërthimit, sipas raportimeve, është identifikuar me emër, ndërsa shumë pak informacion (ndonjëherë aspak) është dhënë për hetimin, motivet, procedimin dhe dënimin nga gjykata të autorit. Pavarësisht nga kjo, një analizë me e thelluar e rrethanave të cilat mundësojnë identifikimin e keqbërësve, sugjeron që më shumë se rezultat i hetimit, ka qenë profili i autorëve që ka sjellë identifikimin e tyre. Kështu, në disa raste, autori ka sfiduar hapur objektivin e tij, duke injoruar të maskojë aktin (p.sh. në rastin e sulmit ndaj Kryetarit të Bashkisë të Lushnjës, të kryer nga ish shoferi i tij, akti ndodhi ndërsa Kryetari ishte në zyrë. Në një rast tjetër, në Vlorë, më 31.03.2019, një individ aktivizoi një ngarkesë eksplozivi kundër banesës të të atit për shkak të konflikteve të pronësisë). Në disa raste të tjera (nga 12 të përmendura më lart) veprimet e keqbërësve kanë qenë shumë amatoreske, duke lënë mjaft gjurmë të akteve të tyre (sidomos në kamerat e sigurisë – CCTV) duke i mundësuar policisë identifikimin dhe arrestimin e tyre në një kohë të shkurtër.

Janë katër raste, ku keqbërësit kanë përdorur eksploziva kundër infrastrukturës kritike publike, që i bënë ato të dallohen nga gjithë rastet e tjera të sulmeve me eksploziva. Kështu më 18.05.2018 një hidrocentral në Kukës u dëmtua rëndë me eksploziv, ndërsa në Fushë-Krujë, si rezultat i eksplozivave ndaj shtyllave të tensionit të lartë¹¹, realizuar dy herë (07.01.2019 dhe 18.03.2019, në shtylla të ndryshme) një zonë relativisht e madhe u la pa energji, për një kohë relativisht të gjatë. Në një tjetër rast, në Delvinë, një depo për furnizimin me ujë të pijshëm u dëmtua me eksploziv (04.04.2019) duke shkaktuar probleme në furnizimin me ujë të popullsisë lokale, për disa ditë.

Me siguri, hetimet përkatëse kanë nisur nga autoritetet kompetente pas secilit prej këtyre akteve por asgjë nuk është bërë publike në lidhje me rezultatet e hetimeve, për sa i përket autorëve, motiveve, etj. Sidoqoftë, pavarësisht nga “stili terrorist” në secilin prej këtyre rasteve, ky motiv duket pak i mundshëm, megjithëse nuk mund të përjashtohet plotësisht si mundësi. Të paktën, në rastin e goditjes të shtyllave të tensionit të lartë, motivet më të mundshme duken pakënaqësia e popullsisë lokale ndaj ndotjes, të pretenduar, të shkaktuar nga disa fabrika çimentoje të ngritura atje, gjë që kish provokuar disa herë protesta nga popullsia. Në mbështetje të këtij supozimi, duket edhe vendi i shpërthimit. Ndërsa autori/ët mund të kishin zgjedhur një vend tjetër, më të vështirë për të kryer riparimin e shtyllave, ata preferuan ta kryenin këtë posaçërisht në atë vend, ku sipas shumë analistëve, jo vetëm bllokoi punën e fabrikave, por dukshëm të shtynte të mendoje që qëllimi i autorëve ishin pikërisht fabrikat. Një tjetër detaj që tërheq vëmendjen, është fakti që megjithëse zona përreth fabrikave është e

¹⁰ Bankomatet janë sulmuar me eksploziv tek Ura Vajgurore, më 04.01. 2019 dhe Kavajë, më 26.08.2019 (Shtojca.1)

¹¹ Linja e transmetimit të tensionit të lartë e dëmtuar me eksploziv, është pjesë e linjës Tirana-2 – Podgoricë, që kryen rreth 50% të transmetimit të energjisë elektrike të vendit.

ruajtur mirë me siguri private dhe publike, autorët arritën ta kryenin aktin pa lënë gjurmë, gjë që flet njëherazi për aftësitë e tyre dhe familjarizimin me zonën (me shumë gjasë, banorë të zonës).

Megjithatë, duhet theksuar që, bazuar në disa shenja të para, parakushtet për sulme me eksploziva të motivuara nga terrorizmi, janë të pranishme në Shqipëri. Kështu, më 12.11.2017, Policia Shqiptare arrestoi në Pogradec një 29 vjeçar, të konsideruar nga agjencitë shqiptare të sigurisë si person me rrezikshmëri të lartë¹². Në banesën e tij u gjet një sasi e konsiderueshme eksplozivi (tritol) dhe municione. Ai ishte kthyer rishtazi nga Siria dhe ishte përgjuar nga agjencitë shqiptare të zbulimit duke komunikuar me persona të tjerë në Shkodër, të cilët u arrestuan gjithashtu, me akuzën për planifikimin e një sulmi në Shqipëri kundër skuadrës izraelite të futbollit (i konsideruar si akt me motive fetare)¹³. Numri i përgjithshëm i shtetasve shqiptarë që iu bashkuan konfliktit në Siri dhe Irak gjatë viteve 2011-14 vlerësohet në 144 shtetas, nga të cilët 45 janë kthyer në Shqipëri¹⁴.

Është interesante që deri tani, asnjë i huaj, i bazuar në Shqipëri nuk është bërë objektivi i sulmeve me eksploziva të ndodhura në periudhën që analizohet. Sidoqoftë, ky fakt mund të ndryshojë në të ardhmen, veçanërisht në rastin e një sulmi me motive terroriste.

Fusha (kolona) e fundit e bazës të të dhënave për sulmet me eksploziva (Shtojca1) paraqet ashpërsinë e çdo rasti (nga pikëpamja e pasojave) nëpërmjet një kategorizimi me katër ngjyra-kode: E kuqe="shumë të rënda"; Portokalli="të rënda"; "E verdhë e errët="të moderuara"; E verdhë e çelur="të lehta apo të parëndësishme". Bazuar në këtë kategorizim, duket se vetëm në 6 raste (3.8% e totalit) pasojat e shpërthimit ka qenë "shumë të rënda". Në 28 raste të tjera (17.8% e totalit) pasojat kanë qenë "të rënda". Në 19 raste (12% e totalit) ato kanë qenë "të moderuara", ndërsa në 104 raste, ose 66.4% e totalit, pasojat e shpërthimit kanë qenë "të lehta ose të parëndësishme". Këto shifra dëshmojnë qartë që me gjithë frekuencën relativisht të lartë të sulmeve me eksploziva (2.4 në muaj) qëllimi final i autorëve duket të ketë qenë më shumë frikësimi i objektivit ose presioni me qëllim fitimi (gjobë vënie) dhe jo vrasja e tij apo zhdukja fare e biznesit apo pronës. Ky konkluzion të çon tek një deduksion tjetër, në lidhje me natyrën e këtyre sulmeve, si tërësisht me "motive kriminale". Në rastin e përdorimit të eksplozivit për qëllime terroriste, sikurse ka treguar përvoja në vende të tjera, pasojat sigurisht që do të ishin shumë më të rënda.

Siç shihet nga tabela në Shtojcën 1, tipi i eksplozivit të përdorur gjatë periudhës së analizuar ka qenë kryesisht tritol. Granatat e dorës janë përdorur në 5 raste (3.2% e totalit të sulmeve me eksploziva) ndërsa C4, siç raportohet, është përdorur në vetëm 2 raste (1.2% e totalit). Kjo "preferencë" ndaj tritolit e autorëve të shpërthimeve në krahasim me materialet e tjera plasëse, shpjegohet kryesisht me lehtësinë relative të gjetjes së tij, por edhe me çmimin më të lirë në tregun ilegal të armëve. Aktualisht, trafikimi/tregtia ilegale e armëve në Shqipëri përbën rreth 18% të totalit të të ardhurave nga aktivitetet kriminale të grupeve të krimit të organizuar (GKO).

¹² Sot.com (2016). Hetimet, Ervin Duka, komunikim me shqiptarë që luftonin në Siri. E disponueshme në <https://sot.com.al/aktualitet/hetimet-ervin-duka-komunikim-me-shqiptar%C3%AB-q%C3%AB-luftonin-n%C3%AB-siri>.

¹³ Në 2020 të arrestuarit u shpallën të pafajshëm, Zëri (2020) Dyshimet për sulm terrorist në ndeshjen Shqipëri-Izrael, merret vendimi për 4 të arrestuarit. E disponueshme në <https://www.zeri.info/sport/349445/dyshimet-per-sulm-terrorist-ne-ndeshjen-shqiperi-izrael-merret-vendimi-per-4-te-arrestuarit/>

¹⁴ Nga shtetasit shqiptarë që iu bashkuan konfliktit në Siri dhe Irak gjatë viteve 2011-14, besohet se 28 kanë vdekur në zonën e konfliktit, dhe 37 (gra dhe fëmijë) janë riatdhesuar nga shteti shqiptar në vitet 2020 dhe 2021. Ndërkohë procesi i riatdhesimit për rreth 50 personat e mbetur është në vazhdim, PREVEX, 2021. D5.2 Working Paper on enabling environments, drivers, and occurrence/non-occurrence of violent extremism. https://www.prevex-balkan-mena.eu/wp-content/uploads/2022/03/D5.2-FINAL_3019-1.pdf.

Ai është i dyti pas trafikut të drogave (42% të totalit të të ardhurave të GKO-ve)¹⁵. Megjithatë, edhe burime të tjera alternative janë shfrytëzuar gjithashtu nga grupet kriminale për sigurimin e armatimeve dhe municioneve. Ka disa raste që mbështesin këtë konkluzion, nga të cilët me më shumë jehonë ishte kapja nga policia, në një aksion të vetëm, në fshatin Badër (Dibër) më 26.10.2022, e 1.16 ton tritol dhe 3815 kapsollave elektrike, duke arrestuar dy persona (shih Shtojcën 2). Një sasi kaq e madhe tritolit shpjegohet me praninë e disa minierave në atë rajon dhe përdorimin rutinë të tritolit në aktivitetin e tyre, gjë që mund të jetë shfrytëzuar nga keqbërësit për sigurimin e kësaj sasive eksplozivi.

Më herët, më 09.01.2019, një sasi e konsiderueshme armatimi dhe municioni u grabit nga baza ushtarake detare e Pasha-Limanit, pranë Vlorës (një nga dy bazat kryesore detare të Shqipërisë, të konsideruara si shumë të sigurta). Sipas Policisë së Shtetit, grabitësit kishin bashkëpunuar me njerëz që punonin brenda bazës, sepse rojet kishin lënë postet e tyre pak para kohës së supozuar të grabitjes. Me municionin e vjedhur, ishin dhe 60 granata dore. Megjithatë, sipas bazave të të dhënave në Shtojcën 1 dhe Shtojcën 2, sikurse u përmend më lart, përdorimi i granatave të dorës në Shqipëri, në kuadrin e përgjithshëm të sulmeve me eksploziva, është minimal. Kështu, grabitja e armatimit dhe granatave në bazën e Pasha-Limanit, dyshohet të jetë bërë me qëllim shitjen (siç u përmend më lart, tregu ilegal i armëve është një burim i rëndësishëm të ardhurash për GKO-të në Shqipëri). Nga ana tjetër, rasti i bazës së Pasha Limanit tregon aftësinë e GKO-ve për të penetruar dhe gjetur bashkëpunëtorë për qëllimet e tyre të sigurimit të armatimit, deri edhe në disa nga vendet e supozuara me siguri të lartë, si bazat ushtarake.

Eksplozivat-kurth, me mekanizma të improvizuara për “vetë-aktivizim”, janë përdorur në vetëm tre raste (gjatë periudhës së analizuar). Të aktivizuara (pa e ditur) nga vetë viktimat, ato kanë shkaktuar plagosjen e tyre në 100% të rasteve. Kështu, shpërthimi i parë i kësaj natyre, i kryer në Tiranë, më 15.05.2018, shkaktoi plagosjen e të dy bashkëshortëve. Dy shpërthime të tjerë, njeri në Gjirokastër, më 25.02.2019 dhe pastaj përsëri në Tiranë, më 09.02.2021, rezultuan në plagosjen përkatësisht të një personi në secilin prej tyre. Një “efikasitet” i tillë i eksplozivave-kurth mund të nxisë aplikime më të shpeshta të tyre, në të ardhmen, me mundësinë që numri i viktimave të rritet, veçanërisht, midis të tjerash, për shkak të faktit që raportet e mediave, në raste të tilla, japin çdo detaj për mënyrën se si eksplozivi-kurth ishte ndërtuar dhe aktivizuar, duke ofruar kështu “know-how” të gatshme dhe falas.

Nga ana tjetër, ka një rast, ku keqbërësi/sit kanë përdorur një dron për të transportuar dhe ulur ngarkesën plasëse brenda një fabrike për të shmangur muret rrethues dhe masat e tjera të sigurisë¹⁶. Ndërsa për shkak të atmosferës të ngarkuar politike kjo ngjarje kaloi pothuajse pa jehonë, ajo, së bashku me ngarkesat e aktivizuara në distancë (zakonisht me telefon celular) mund të paralajmërojë kalimin në një fazë të re, metodash dhe pajisjes shpërthyesë më të sofistikuar, për t’u garantuar keqbërësve më shumë sukses ndaj shënjestrave të tyre, duke shmangur njëkohësisht përpjekjet e agjencive të sigurisë publike për kapjen e tyre.

Për sa i përket shpërndarjes gjeografike të sulmeve me eksploziva, siç shihet në tabelë (fig.2) dhe grafikun (fig.3) ato janë realizuar kryesisht në Tiranë (21.8%); Vlorë (14.7%); Fushë-Krujë (12.8%); Durrës (~9%) dhe Shkodër (~7.7%). Duke marrë në konsideratë edhe rastet e eksplozivave të kapura (tabela në fig.4 dhe grafiku në fig.5) Lezha, shfaqet gjithashtu si mjaft i prekur nga incidentet me eksploziva (me 16.2% të eksplozivave të kapura atje). Harta në fig.6 na jep një pamje vizuale më të mirë të vendeve me më shumë incidente me eksploziva (marrë

¹⁵ Fabian Zhilla, Besfort Lamallari “Vlerësim i rrezikut të krimit të organizuar në Shqipëri” (anglisht) f.16 https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2018/02/Threat_Assessment_of_Albanian_Organised.pdf

¹⁶ Sulmi me eksploziv të transportuar me dron u krye në Durrës, më 10.06.2021, kundër një biznesi (fabrikë) në pronësi të L.K. një biznesmen dhe politikan i mirënjohur.

së bashku, të shpërthyer dhe të kapura). Dukshëm, ato kanë ndodhur në rajonin në formë gjysmëhëne Tiranë-Shkodër-Durrës-Vlorë.




Fig. 3 Sulmet me eksploziva sipas rajoneve (01.06.2017 – 10.12.2022)

Sn	Rajoni	Rastet	%
1	Elbasani	10	13.5%
2	Fier	2	2.7%
3	Krujë	2	2.7%
4	Kukës	2	2.7%
5	Kurbin	2	2.7%
6	Lezha	12	16.2%
7	Pogradec	2	2.7%
8	Shkodër	3	4.1%
9	Tirana	9	12.2%
10	Vlora	9	12.2%
11	Others	21	28.4%
Total		74	100.0%

Fig.4. Eksploziva të kapura sipas rajoneve (01.06.2017 – 10.12.2022)




Fig. 5 Eksploziva të kapura sipas rajoneve (01.06.2017 – 10.12.2022)

Nr	Rajonet	Incidentet		Vdekje	Plagosje
		No	%		
1	Berat	1	0.64%		
2	Burrë	1	0.64%		
3	Delvinë	3	1.92%		
4	Dibër	3	1.92%		
5	Durrës	14	8.97%		
6	Elbasan	5	3.21%	1	1
7	Fier	3	1.92%		1
8	Fushë Krujë	20	12.82%		
9	Gjirokastrë	4	2.56%		2
10	Kavajë	2	1.28%		
11	Krujë	1	0.64%		
12	Kukës	2	1.28%		
13	Laç	2	1.28%		
14	Lezhë	9	5.77%		
15	Lushnje	6	3.85%		
16	Mat	1	0.64%		
17	Përrenjas	1	0.64%		
18	Pogradec	5	3.21%	1	
19	Rrëshen	1	0.64%		
20	Sarandë	3	1.92%		
21	Shkodër	12	7.69%		3
22	Tiranë	34	21.79%	1	8
23	Vlorë	23	14.74%		3
Total		156	100.00%	3	15

Fig.2. Sulmet me eksploziva sipas rajoneve 01.06.2017 – 10.12.2022)

Eksplozivat e kapura

Baza e të dhënave për eksplozivat e kapura gjatë periudhës 01.06.2017 – 10.12.2022 (një version paksa i thjeshtëzuar paraqitet në Shtojcën 2 në fund) përbën një burim tjetër të rëndësishëm në lidhje me përdorimin e eksplozivave në Shqipëri. Kështu, gjatë kësaj periudhe, janë raportuar 74 raste, në të cilat policia ka mundur të ndërhyjë në kohë dhe arrestojë poseduesit/transportuesit e eksplozivave. Sigurisht që kjo është arritur falë informacionit operativ të mbledhur nga policia, në lidhje me “kush”, “çfarë”, “kur” dhe “ku”. Megjithëse, krahasuar me rastet e eksplozivave të ekzekutuara, numri i rasteve të eksplozivave të kapura është më i ulët (rreth 47% të numrit të rasteve të ekzekutuara, ose një raport 1:2 në favor të rasteve të ekzekutuara) përsëri kjo përbën një sukses nga ana e policisë, po të mbahen parasysh problemet prej të cilave policia ende vuan, sidomos në aspektin e kompletimit me njerëz e pajisje. Më konkretisht, nga baza e të dhënave në Shtojcën 2 shihet që kanë qenë 96 persona në total, të identifikuar e arrestuar nga policia si të implikuar me eksplozivat (megjithatë asnjëherë nuk është sqaruar kategoria e tyre: “prodhues”, “vendosës” apo thjesht “transportues”). Nga ana tjetër, vështirë ndonjë prej të arrestuarve për posedim eksplozivash i takon niveleve të mesme, apo të larta të hierarkisë së krimit në Shqipëri (të paktën ky informacion nuk është dhënë nga ALZ). Përveç të arrestuarve, gjatë këtyre operacioneve u kapën 106 ngarkesa eksplozive dhe një sasi e madhe pjesës ndihmëse (përveç 1.16 ton tritol dhe 3815 kapsollave elektrike të kapura në një rast të vetëm, më 26.10.2022, të përmendur më lart).

Për sa i përket armatimit, në posedim të keqbërësve në momentin e operacioneve të policisë, raportohen të kapura: 21 kallaçnikovë, 8 pushkë, 29 pistoleta, 2 shotganë, 1 pushkë snajper dhe dy pushkë të tjera të përshtatura me shënjestër optike, 3 armë gjahu, 1 mitraloz, dhe një sasi e madhe municioni, përfshi fishekë blindshpues. Droga, si bashkëshoqëruese e eksplozivave apo në banesat e të arrestuarve, gjatë kontrolleve vijues, u kap në 20 raste, kryesisht kanabis, kurse kokainë dhe heroinë u kap veças në dy raste.

Qartazi, një sasi e tillë armatimi e municioni, si dhe lloji i tyre, së bashku me drogën e kapur me to, dëshmon sofistikimin e krimit të organizuar por edhe nivelin e zhvilluar të tregut ilegal të armëve në Shqipëri, përmendur më lart. Gjithashtu, mund të supozohet që një sasi e madhe




Fig. 6 Rajonet me incidencën më të madhe të eksplozivave (01.06.2017 – 10.12.2022)

armatimi e municioni, grabitur nga depot ushtarake në Shqipëri, gjatë trazirave të vitit 1997¹⁷ ende qarkullon nëpër duart e kriminelëve apo individëve të tjerë (pavarësisht se një pjesë e tij është mbledhur nga Qeveria nëpërmjet programeve të ndryshme, ndërsa një sasi e rëndësishme supozohet të ketë dalë nga Shqipëria nëpërmjet tregtisë ilegale ndërkombëtare). Një tregues i qartë i lehtësisë së gjetjes së armëve në Shqipëri është fakti që gati pas çdo krimi, për të shmangur hetimin dhe rënien në gjurmë të autorëve, automjeti dhe armatimi i përdorur është djegur. Nga ana tjetër, shifrat e dhëna më lart tregojnë nivelin e sfidës që ALZ-të kanë përpara për të vënë nën kontroll krimin e organizuar në Shqipëri.

Eksplziv C4, raportohet të jetë kapur në 8 raste, por është e paqartë sasia totale e kapur në këto aksione (vetëm në tre raste, për shkak të detajeve në raport, sasia e C4 arrin në 3.6kg). Ngjashëm me rastet e eksplozivave të shpërthyer, pjesa kryesore e eksplozivit të kapur ka qenë tritol, gjë që, siç u argumentua më lart, shpjegohet me disponueshmërinë dhe çmimin e këtij tipi eksplozivi në Shqipëri. Në 12 raste, u kapën granata dore (62 copë gjithsej). Në një rast (31.10.2022) u kapën 3 mina kundërtanke (me gjasë për të shfrytëzuar tritolin e tyre – 5.7kg për copë). Shembujt e fundit tregojnë fleksibilitetin dhe “kreativitetin” e kriminit të organizuar, për të shfrytëzuar e modifikuar çdo material apo pajisje që mund të përdoret si mjet shpërthyes.

Në 16 raste (21.6% e totalit) ngarkesat e kapura ishin pajisur me mekanizma të aktivizimit në distancë (nëpërmjet telefonit celular) një preferencë kjo në këtë treg, për shkak të sigurisë të suksesit ndaj objektivit të synuar dhe lehtësisë së autorëve për të vepruar të pa diktuar. Duke qenë se, si për çdo mall tregu, kërkesë-oferta mund të bëjë që në të ardhmen çmimi¹⁸ për këto mekanizma të mundësojë gjetjen e përdorimit nga një masë më e madhe keqbërësish, kjo do të sjellë një rrezik të rritur për objektivat e shënjestruar por edhe për sigurinë në përgjithësi në Shqipëri.

Në 46 raste të eksplozivave të kapura (nga 74 në total, ose në 67% të tyre) operacioni ishte planifikuar qysh më parë (në vitin 2022, 14 operacione të planifikuara, ose 30% e operacioneve të planifikuara) gjë që dëshmon aftësitë në rritje të policisë dhe agjencive të tjera ligj zbatuese në Shqipëri, për mbledhjen e informacionit përkatës, si gati e vetmja dhe më e efektshmja mënyrë për t'u ndeshur me këtë lloj krimi.

Pas analizës veças të rasteve me eksploziva të shpërthyer e atyre të kapura, një kombinim i të dhënave nga të dy tabelat e Shtojcën 1 dhe Shtojcën 2, mundësoi grafikun (fig.7) i cili ndihmon për nxjerrjen e disa përfundimeve të tjera të rëndësishme. Para së gjithash, bie në sy një trend rritës, megjithëse i butë, i numrit të sulmeve me eksploziva (vija e kuqe e ndërprerë). Një trend i tillë vihet re edhe për rastet e eksplozivave të kapura (vija blu e ndërprerë). Përveç kësaj, bien në sy disa kulme në grafik në Q (tremujor) 1/2019, Q4/2020, Q2/2021 dhe Q2/2022. Sikurse dihet, këto periudha përkojnë respektivisht me trazirat politike të 2019 (protesta të dhunshme të opozitës në mars-maj dhe atmosfera e ngjashme që shoqëroi zgjedhjet lokale të 30 qershorit 2019, me konflikte të opozitës sidomos në bastionet e saj, si p.sh. Shkodra); zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të 25 prillit 2021, konfliktet brenda opozitës të fillim vitit 2022, të cilat në ndonjë rast u përshkallëzuan deri në përplasje të dhunshme midis fraksioneve opozitarë, etj.

¹⁷ Vlerësohet që vetëm kallaçnikovë, u vodhën atë vit, nga depot ushtarake, rreth 226,000 copë. Zhilla, Lamallari, “Evoluimi i grupeve kriminale të organizuara në Shqipëri” (anglisht) f.23. https://www.osfa.al/sites/default/files/evolution_of_the_albanian_organized_crime_groups.pdf

¹⁸ Raportohet se çmimi aktual për këto lloj ngarkesash shkon rreth 1,500 – 3,000 EUR. Alert.al (2020). Mina me telekomandë të lidhura me celular, në shitje për 3 mijë euro. E disponueshme në <https://alert.al/kryesore/mina-me-telekomande-te-lidhura-me-celular-ne-shitje-per-3-mije-euro/>

Nga tre rastet e përmendura më herët, ku aktivistët e opozitës u bënë objekt i eksplozivave në banesat e tyre, dy përkohë me periudha të tensioneve politike, konkretisht në 08.08.2019




Fig.7. Trendi i incidenteve me eksploziva (shpërthyer & kapur) 01.06.2017 – 10.12.2022

(zgjedhjet lokale¹⁹) dhe 23.05.2021 (pas zgjedhjeve parlamentare²⁰). Është interesante gjithashtu që nga katër rastet e sulmit me eksploziv të infrastrukturës kritike (të përmendura më lart) tre të fundit ndodhën në periudhën Janar – Prill 2019, që siç u përmend, ishte mjaft e tensionuar politikisht.

Bazuar në sa më sipër, mund të konkludohet që ka një korrelacion të dukshëm midis situatës politike dhe sulmeve me eksploziva (sulme që përbëjnë një tregues të rëndësishëm të situatës së sigurisë/kriminalitetit në përgjithësi në Shqipëri). Ky konkluzion duket bindës po të mbahet parasysh gjithashtu ngarkesa që agjencitë e sigurisë publike në Shqipëri (policia në veçanti e cila mbetet e pa kompletuar si duhet në personel dhe pajisje) detyrohen të përballojnë gjatë tensioneve politike. Sipas raporteve, në shumë raste, një pjesë e efektivit të Policisë së Shtetit janë lëvizur prej rretheve të tyre në drejtim të Tiranës, për të mbështetur forcat e policisë atje, gjatë protestave të opozitës apo për të siguruar mitingjet e partive të ndryshme, gjatë fushatave elektorale. Këto ridislokime të përkohshme kanë shkaktuar mbingarkesa edhe për pjesën e policisë të mbetur në rajonet e përherëshme, të cilëve u është dashur që me më pak forca të sigurojnë rendin publik në rajonet e tyre, detyrë më e vështirë se normalisht për shkak të së njëjtës atmosferë të rënduar politike edhe atje.

Është me interes të shihet që, sipas grafikut në fig.7, numri i sulmeve me eksploziva në Q3/17 është minimal, megjithëse në 25.06.2017 u mbajtën zgjedhje parlamentare. Në fakt, kjo e mbështet më mirë konkluzionin e mësipërm, sepse siç dihet, për shkak të marrëveshjes të 17 Majit, midis dy udhëheqësve të Partisë Socialiste (në pushtet) dhe Partisë Demokratike (partia kryesore e opozitës) që solli ndarje pushteti, duke i dhënë PD një numër postesh ministeriale dhe në institucione të tjera të rëndësishme, për disa muaj, para dhe pas zgjedhjeve, e gjithë fushata elektorale u karakterizua nga tone të ulëta (diçka unike në Shqipëri). Kjo atmosferë e qetë politike vijoi për disa muaj, pas zgjedhjeve, për t'u acaruar gradualisht përsëri, me rimarrjen nga PS (si fitues i zgjedhjeve) të të gjitha posteve të dhëna më parë PD.

Ndërsa ka një korrelacion të ngushtë midis situatës politike në Shqipëri dhe frekuencës së sulmeve me eksploziva gjatë periudhës që analizohet, grafiku në fig.7, na tregon gjithashtu një raport të zhdrejtë midis rasteve të shpërthimit të eksplozivave dhe atyre të kapura nga policia. Duket sikur, sipas një rregullsie gati perfekte, sa herë që numri i eksplozivave të kapur (linja blu) rritet, numri i eksplozivave të shpërthyer (linja e kuqe) ulet dhe anasjelltas (me përjashtim vetëm të Q2/2022). Kuptueshëm, çdo rast në të cilin policia ka ndërhyrë në kohë dhe kapur eksploziva, duke arrestuar gjithashtu personat në posedim të tyre, jo vetëm që ndikon

¹⁹ Zgjedhjet lokale në reference u mbajtën më 30.04.2019 me tensione e dhunë para e pas tyre.

²⁰ Zgjedhjet parlamentare të përmendura u zhvilluan më 25.04.2021 dhe u karakterizuan nga dhunë, deri një humbje jete si dhe një kundërshtim disa mujor, nga pala humbëse, të rezultatit të zgjedhjeve.

materialisht mbi këto sulme, duke arrestuar autorët potencialë dhe privuar ata nga një sasi materiale shpërthyes, por edhe psikologjikisht, përcjell një mesazh të fortë tek grupet kriminale, duke i detyruar ata të frenohen (qoftë edhe përkohësisht) dhe të bëjnë vlerësimet e tyre “kosto-përfitim” në lidhje me dobinë e vijimit me këto metoda.

Përfundime

Sikurse del nga analiza e incidenteve me eksploziva, veçanërisht nga frekuenca mujore prej rreth 3.5 incidentesh (2.4 të ekzekutuara dhe 1.1 të kapura) përdorimi i eksplozivave në Shqipëri, në 5.5 vitet e fundit (sidomos ato të komanduara nga distanca, të vendosura në automjete apo banesa e biznese private) konsiderohet një mjet i preferuar në duart e grupeve kriminale ndaj objektivave të tyre, qofshin ato grupe rivale apo palë të treta. Për fat të keq, duke u bërë një “mjet mjaft në modë” për rregullimin e konflikteve, eksplozivat po përdoren edhe nga keqbërës të tjerë, si një “armë e zgjedhur”, duke e kthyer këtë fenomen në një shqetësim të madh sigurie në Shqipëri, me efekte të mëdha fizike (përfshi jetë njerëzore) e psikologjike, kundrejt viktimave, por edhe ndaj gjithë shoqërisë shqiptare.

Deri tani, sulmet me eksploziva duket se në Shqipëri po aplikohen kryesisht nga grupet e krimit të organizuar (GKO-të) si mjet për larje hesapesh me rivalët. Megjithatë, sulmet me eksploziva, si metodë terroriste, nuk duhet të përjashtohen, sidomos për shkak të disa tendencave/tentativave fillestare të shfaqura herë pas here. Për më tepër, sot *“ka një shkrirje në rritje [të metodave] të terrorizmit dhe krimit të organizuar [...kështu] përpjekja për të bërë dallimin midis tyre do të ishte kundër produktive”*²¹.

Për shkak të vështirësisë për të bërë diferencën midis akteve kriminale dhe atyre me motive terroriste, ka pasur disa raste sulmesh me eksploziva në Shqipëri që gabimisht janë klasifikuar si “akte terroriste”, duke bërë që situata e sigurisë të duket më e zyrtë. Në fakt, për momentin, mundësia e sulmeve me motive terroriste me përdorim të eksplozivave duket e ulët.

Në rast motivimi terrorist, sulmet me eksploziva do të jenë të ndryshëm në aspektin e objektivave, duke synuar prishjen e jetës normale të komunitetit dhe shkatërrimin e infrastrukturës kritike, ndërsa ngarkesat shpërthyese do të jenë më të mëdha, për të shkaktuar dëme sa më të rënda. Në të tilla raste, përveç sa më sipër, objekt i këtyre sulmeve është e pritshme të jenë disa projekte/kompani të mëdha në Shqipëri, veçanërisht ato ndërkombëtare, për shkak të profilit të lartë të tyre (të konsideruara si projekte të BE). Edhe pse niveli i kërcënimit terrorist në Shqipëri ka qenë i ulët, shfrytëzimi i propagandës dhe teknologjive të komunikimit online për aktivitete radikalizuese dhe rekrutuese mund të bëhen shumë shqetësuese. Grupet terroriste janë shpërndarë në platforma të tjera komunikimi për të decentralizuar edhe më tej propagandën dhe shpërndarjen e retorikës dhe ideologjisë së tyre. Lidhja e elementëve radikalë me luftëtarët e huaj terroristë (LHT) apo organizata terroriste janë faktorë nxitës të aktivitetit të mundshëm terrorist²², nga grupe ose qoftë edhe “ujqër të vetmuar”²³, të radikalizuar, për të ndërmarrë sulme të tilla. Kjo është edhe më e rëndësishme në një kohë që kapacitetet e shtetit për parandalim/reagim mbeten të limituara dhe ende “në konsolidim”. Infrastruktura kritike në Shqipëri është e cënueshme ndaj këtyre sulmeve edhe në zona të mirë-ruajtura (sikurse kanë dëshmuar sulmet ndaj shtyllave të tensionit të lartë në Fushë-Krujë).

Pavarësisht nga natyra e një sulmi – me motiv kriminal apo terrorist – mjetet (përfshi eksplozivat) do të jenë në zgjedhjen e autorit. Në këto kushte, çdo organizatë duhet të marrë

²¹ Mark Shaw, Prem Mahadevan. “Kur terrorizmi dhe krimi i organizuar takohen”, (anglisht)

https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2018/10/PP6-7_2018-1.pdf

²² Shërbimi Informativ i Shtetit, Raporti Publik 2021. I disponueshëm në <https://www.shish.gov.al/files/Public%20Report%202021%20Shqip.pdf>.

²³ “Ujk i vetmuar” = këtu në kuptimin e një terroristi ose kriminel i cili vepron i vetëm dhe jo si pjesë e një organizate

me kohë masat përkatëse, me qëllim që të shmangë, zbutë efektet dhe ringrihet pas një sulmi të tillë, të mbrojë jetën e personelit, fasilitetet dhe reputacionin. Për këtë, përveç agjencive të sigurisë publike, këto risqe duhet të njihen e merren në konsideratë edhe nga ndërmarrjet private, veçanërisht kompanitë e mesme e të mëdha. Kjo kërkon vlerësime të vazhdueshme të rreziqeve që lidhen me eksplozivat, masa adekuate parandalimi e minimizimi të pasojave, protokolle të investigimit e raportimit të incidenteve, etj, ndërsa masat e ringritjes duhet të jenë përherë një pjesë e rëndësishme e përballjes me këto rreziqe.

Evidenca e deritanishme ka treguar që komuniteti/individët e huaj rezidentë në Shqipëri, nuk kanë qenë objekt i sulmeve të GKO-ve. Megjithatë, ata mund të ekspozohen ndaj rrezikut aksidental, si pjesë e “pasojave shoqëruese”, të kapur pa dashje në “vijën e zjarrit”. Krejt ndryshe, në rastin e sulmeve me motive terroriste, komuniteti dhe bizneset e huaja në Shqipëri do të jenë një objektiv i preferuar i tyre.

Trafiku ilegal i armëve në Shqipëri përbën një pjesë të rëndësishme të të ardhurave për GKO-të (burimi i dytë, me 18%, pas trafikut të drogës). Kjo sigurisht i nxit GKO-të t'i ruajnë këto operacione, duke krijuar e mbajtur kështu një mjedis inkurajues e të nxehtë për trafikimin e përdorimin e eksplozivave, të paktën për një të ardhme afatmesme.

Rekomandime

Korrelacioni midis tenseve politike/sociale në vend dhe krimit të organizuar, siç u provua më lart, apelon që faktorët politikë të shmangin konfrontimet e ashpra politike dhe të përpiqen të përmbushin rolin dhe funksionet e tyre legjitime brenda institucioneve politike dhe në mënyrë kushtetuese.

Duke qenë se gjatë sulmeve me eksploziva, provat materiale pas shpërthimit që do të mund të shfrytëzoheshin nga hetuesit, në rastin më të mirë janë minimale, mënyra më efikase për ta vënë nën kontroll këtë fenomen është informacioni dhe bazuar në të, parandalimi i këtyre sulmeve përpara se të ndodhin. Për këtë qëllim ALZ-të duhet të përsosin e ngrenë më tej kapacitetet e tyre të mbledhjes së informacionit, paralelisht me ato për vlerësime të rreziqeve dhe analizat prognozë.

Duke ditur lehtësinë relative për gjetjen në Shqipëri të eksplozivave dhe pajisjeve përkatëse ndihmëse, çdo përpjekje e ALZ-ve dhe institucioneve të tjera shtetërore për të shtrënguar (në mos jo plotësisht mbyllur) burimet e furnizimit me to, do të kontribuonte ndjeshëm në uljen e numrit të këtyre sulmeve. Në këtë kontekst, çdo lëvizje (import, eksport, etj.) e këtyre materialeve për qëllime industriale apo ushtarake duhet të kontrollohet, dokumentohet, inspektohet e verifikohet me rreptësi.

Kompanitë shtetërore e private (veçanërisht të mesme dhe të mëdha) duhet të hartojnë skenarë realistë, bazuar në vlerësimet e rreziqeve, për të orientuar e mbështetur planet e sigurisë dhe përgatitjen përkatëse, në koordinim me ALZ-të, për të përballuar aktet e qëllimshme kundër tyre, përfshi sulmet me eksploziva. Në këtë drejtim, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet trajnimit të personelit në përgjithësi dhe sidomos stafit që merren me postën dhe vizitorët, për të parandaluar rrezikun e kalimit të "pakove bombë" dhe materialeve të tjera të rrezikshme brenda zyrave apo kantierëve të kompanisë. Pjesë e rëndësishme e trajnimit të personelit në përballimin e sulmit me eksploziva duhet të jetë reagimi individual dhe kolektiv për t'u mbrojtur e minimizuar efektet e tyre.

Duke qenë se në një sulm terrorist me eksploziv efekti shkatërrues parashikohet të jetë shumë më i madh nga sa është parë deri tani në Shqipëri, ndërsa, nga ana tjetër, tërmeti i 2019 dhe përmbajtjet në Shqipëri, kanë nxjerrë në pah kapacitetet e limituara të shtetit për kërkim e shpëtim (SAR) duhet të konsiderohet prioritet i dorës së parë fuqizimi e modernizimi i këtyre kapaciteteve, së bashku me ndihmën e parë mjekësore dhe evakuimin. Këto kapacitete (njerëzore e materiale) duhet të alokohen drejt në agjencitë qendrore dhe lokale të emergjencave civile ndërsa motivimi, shpërblimi, trajnimi e testimi i këtij personeli duhet të jenë të tillë që të garantojnë përmbushjen e misionit.

Bibliografi

Alert.al (2020). Mina me telekomandë të lidhura me celular, në shitje për 3 mijë euro. <https://alert.al/kryesore/mina-me-telekomande-te-lidhura-me-celular-ne-shitje-per-3-mije-euro/>.

Departamenti i Shtetit i ShBA (OSAC) Albania 2016 Crime and Safety Report

Fabian Zhilla, Besfort Lamallari “Vlerësim i rrezikut të krimit të organizuar në Shqipëri” (anglisht) f.16

[https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2018/02/Threat Assessment of Albanian Organised.pdf](https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2018/02/Threat-Assessment-of-Albanian-Organised.pdf).

Instituti i Statistikave, Popullsia e Shqipërisë <http://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/popullsia/publikimet/2022/popullsia-e-shqip%C3%ABris%C3%AB-1-janar-2022/>.

Mark Shaw, Prem Mahadevan. “Kur terrorizmi dhe krimi i organizuar takohen” (anglisht) https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2018/10/PP6-7_2018-1.pdf.

PREVEX, 2021. D5.2 Working Paper on enabling environments, drivers, and occurrence/non-occurrence of violent extremism (anglisht) https://www.prevex-balkan-mena.eu/wp-content/uploads/2022/03/D5.2-FINAL_3019-1.pdf.

Sot.com (2016). Hetimet, Ervin Duka, komunikim me shqiptarë që luftonin në Siri. <https://sot.com.al/aktualitet/hetimet-ervin-duka-komunikim-me-shqiptar%C3%AB-q%C3%AB-luftonin-n%C3%AB-siri>.

Strategjia e kontrollit të armëve të vogla dhe të lehta, municioneve të tyre dhe eksplozivave, 2019-2024” (anglisht) <https://www.seesac.org/f/docs/Albania-1/ENG-Albanian-Strategy-on-Firearms-Control-24-06-2019.pdf>.

Syri.net (2020). Arrestohet autori i tritolit në lokalit pranë ‘Petro Ninit’/ Dëshmia në polici: Eksplozivi ishte porosi. <https://www.syri.net/kronike/346846/arrestohet-autori-i-tritoli-ne-lokalin-prane-petro-ninit-deshmia-ne-polici-eksplozivi-ishte-porosi/>.

Shërbimi Informativ i Shtetit, Raporti Publik 2021. <https://www.shish.gov.al/files/Public%20Report%202021%20Shqip.pdf>.

Zëri (2020) Dyshimet për sulm terrorist në ndeshjen Shqipëri-Izrael, merret vendimi për 4 të arrestuarit. <https://www.zeri.info/sport/349445/dyshimet-per-sulm-terrorist-ne-ndeshjen-shqiperi-izrael-merret-vendimi-per-4-te-arrestuarit/>.

Shtojca 1: Sulmet me eksploziva në Shqipëri (01.06.2017 – 10.12.2022)

Nr	Viktima		Objektivi	Vendi	Data	Viti	Lloji eksploziv	Niveli i dëmit	Nr	Viktima		Objektivi	Vendi	Data	Viti	Lloji eksploziv	Niveli i dëmit
	Vdekje	Plagosje								Vdekje	Plagosje						
1	Jo	Jo	H.T.	Fushë-Krujë	02.Jun	2017	Tritol		66	Jo	Jo	P.F.	Tiranë	1-Dec	2019	Tritol	
2	Jo	Jo	N.R.	Burrel	04.Jov	2017	Tritol		67	Jo	Jo	M.H.	Tiranë	6-Dec	2019	Tritol	
3	Jo	Jo	Z.S.	Dibër	08.Dec	2017	Tritol		68	Jo	Jo	A.K.	Vlorë	21-Dec	2019	Tritol	
4	Jo	Jo	Ç.Family	Elbasan	25.Dec	2017	Tritol		69	Jo	Jo	P.K.	Tiranë	27-Dec	2019	Tritol	
5	Jo	Jo	K.M.	Tiranë	30.Dec	2017	Tritol		70	Jo	2	F.T. Secretary	Lushnjë	31-Dec	2019	Tritol	
6	Jo	Jo	?	Shkodër	02.Jan	2018	Tritol		71	Jo	Jo	P.M.	Shkodër	5-Jan	2020	Tritol	
7	Jo	Jo	F.P. M.P.	Shkodër	6-Jan	2018	Tritol		72	Jo	Jo	K.B.	Shkodër	6-Jan	2020	Tritol	
8	Jo	Jo	?	Vlorë	06.Jan	2018	Tritol		73	Jo	Jo	O.B.	Durrës	27-Jan	2020	Tritol	
9	Jo	Jo	R.K.	Pogradec	10.Jan	2018	Tritol		74	Jo	Jo	M.S.	Durrës	30-Jan	2020	Tritol	
10	Jo	Jo	A.V.	Fushë-Krujë	11.Jan	2018	Tritol/Gran		75	Jo	Jo	N.A.	Shkodër	6-Feb	2020	Tritol	
11	Jo	3	L.K.	Shkodër	13.Jan	2018	Tritol		76	Jo	Jo	A.M.	Lezhë	15-Feb	2020	Tritol	
12	Jo	1	G.L.	Gjrokastër	23.Jan	2018	Tritol		77	Jo	Jo	K.H.	Tiranë	28-Feb	2020	Tritol	
13	Jo	Jo	S.Sh.	Lushnjë	23.Jan	2018	Tritol		78	Jo	Jo	V.Z.	Delvinë	3-May	2020	Tritol	
14	Jo	Jo	?	Vlorë	09.Apr	2018	Tritol		79	Jo	Jo	B.H.	Tiranë	12-May	2020	Tritol	
15	Jo	Jo	E.A.	Fier	16.Apr	2018	Tritol		80	Jo	Jo	E.M.	Tiranë	30-May	2020	Tritol	
16	Jo	1	E.M.	Fier	21.Apr	2018	Tritol		81	Jo	Jo	?	Vlorë	4-Jun	2020	Tritol	
17	Jo	Jo	F.B. N.B.	Vlorë	02.May	2018	Tritol		82	Jo	Jo	A.K.	Tiranë	11-Jun	2020	Tritol	
18	Jo	Jo	E.Ç.	Vlorë	02.May	2019	Tritol		83	Jo	Jo	E.K.	Fushë-Krujë	14-Jul	2020	Tritol	
19	Jo	2	L.S.	Tiranë	15.May	2018	Tritol		84	Jo	Jo	Gj.LI.	Tiranë	21-Jul	2020	Tritol	
20	Jo	Jo	?	Kukës	18.May	2018	Tritol		85	Jo	Jo	M.T.	Elbasan	4-Aug	2020	Tritol	
21	Jo	Jo	G.D.	Tiranë	27.Jul	2018	Tritol		86	Jo	3	P.Gj.	Tiranë	15-Sep	2020	Tritol	
22	Jo	Jo	L.I.B.	Laç	03.Sep	2018	Tritol		87	Jo	Jo	B.N.	Durrës	8-Oct	2020	Tritol	
23	Jo	Jo	B.M.	Fushë-Krujë	10.Sep	2018	Tritol		88	Jo	Jo	E.N.	Lezhë	30-Oct	2020	Tritol	
24	Jo	Jo	B.F.	Pogradec	16.Sep	2018	Tritol		89	Jo	Jo	Xh.B.	Vlorë	30-Oct	2020	Tritol	
25	Jo	Jo	J.Ç.	Vlorë	23.Sep	2018	Tritol		90	Jo	Jo	S.H.	Durrës	2-Nov	2020	Tritol	
26	Jo	Jo	Ch.Factory	Kukës	23.Sep	2018	Tritol		91	Jo	Jo	T.Ç.	Elbasan	5-Nov	2020	Tritol	
27	Jo	Jo	M.Family	Fushë-Krujë	07.Oct	2018	Tritol		92	Jo	Jo	L.Gj.	Lezhë	19-Nov	2020	Tritol	
28	Jo	1	A.A.	Elbasan	16.Jov	2018	Granate		93	Jo	Jo	H.F.	Shkodër	19-Nov	2020	Tritol	
29	Jo	Jo	A.D.	Durrës	19.Jov	2018	Tritol		94	Jo	Jo	L.Gj.	Lezhë	11-Dec	2020	Tritol	
30	Jo	1	A.A.	Vlorë	23.Jov	2018	Telekomande		95	Jo	Jo	N.B.	Shkodër	26-Dec	2020	Tritol	
31	Jo	Jo	I.L.	Fushë-Krujë	29.Jov	2018	Tritol		96	Jo	Jo	S.N.	Tiranë	23-Jan	2021	Tritol	
32	Jo	Jo	N.Family	Vlorë	14.Dec	2018	Tritol		97	Jo	1	Gj.M.	Tiranë	9-Feb	2021	Tritol	
33	Jo	Jo	V.B.	Vlorë	20.Dec	2018	Tritol		98	Jo	Jo	M.M.	Sarande	9-Feb	2021	Tritol	
34	Jo	Jo	ATMBank	Berat	04.Jan	2019	Tritol		99	Jo	Jo	P.Ç.	Pogradec	21-Feb	2021	Tritol	
35	Jo	Jo	Power Grid Pylon	Fushë-Krujë	07.Jan	2019	Tritol		100	Jo	Jo	A.P.	Fushë-Krujë	9-Mar	2021	Tritol	
36	Jo	Jo	D.H.	Tiranë	22.Jan	2019	Tritol		101	Jo	Jo	A.M.	Tiranë	11-Mar	2021	Tritol	
37	Jo	Jo	N.M.	Gjrokastër	25.Jan	2019	Tritol		102	Jo	Jo	A.A.	Lushne	5-Apr	2021	Tritol	
38	Jo	Jo	A.B.	Vlorë	31.Jan	2019	Tritol		103	Jo	Jo	A.Xh.	Vlorë	12-Apr	2021	Tritol	
39	Jo	Jo	R.Ç.	Fushë-Krujë	31.Jan	2019	Tritol		104	Jo	Jo	Sh.N.	Kurbin	15-Apr	2021	Tritol	
40	Jo	Jo	E.C.	Fushë-Krujë	31.Jan	2019	Tritol		105	Jo	Jo	A.P.	Krujë	18-Apr	2021	Tritol	
41	Jo	1	V.LI.	Gjrokastër	25.Feb	2019	Tritol		106	Jo	Jo	I.V.	Durrës	23-May	2021	Tritol	
42	Jo	Jo	V.S.	Tiranë	28.Feb	2019	Tritol		107	Jo	Jo	B.Ç.	Lushnje	29-May	2021	Tritol	
43	Jo	Jo	Power Grid Pylon	Fushë-Krujë	18.Mar	2019	Tritol		108	Jo	Jo	D.K.	Vlorë	9-Jun	2021	Tritol	
44	Jo	Jo	H.Q.	Durrës	20.Mar	2019	Tritol		109	Jo	Jo	L.K.	Durrës	10-Jun	2021	Tritol	Drone
45	Jo	Jo	A.Ç.	Fushë-Krujë	28.Mar	2019	Tritol		110	Jo	Jo	D.A.	Lezhë	20-Jun	2021	Tritol	
46	Jo	Jo	F.O.	Vlorë	31.Mar	2019	Tritol		111	Jo	Jo	E.D.	Dibër	27-Aug	2021	Tritol	
47	1	Jo	E.Ç.	Pogradec	01.Apr	2019	Granate		112	Jo	Jo	L.K.	Durrës	3-Sep	2021	Tritol	
48	Jo	Jo	Water distrib.	Delvinë	04.Apr	2019	Tritol		113	Jo	Jo	?	Tiranë	5-Sep	2021	?	
49	Jo	Jo	S.X.	Fushë-Krujë	07.Apr	2019	Tritol		114	Jo	Jo	?	Vlorë	7-Sep	2021	?	
50	Jo	Jo	S.Z.	Vlorë	11.Apr	2019	Tritol		115	Jo	1	K.Z.	Vlorë	26-Sep	2021	Granate	
51	Jo	Jo	Dh.K.	Fushë-Krujë	18.Apr	2019	Tritol		116	Jo	Jo	E.H.	Krujë	5-Nov	2021	Tritol	
52	Jo	Jo	?	Fushë-Krujë	19.Apr	2019	Tritol		117	Jo	Jo	R.K.	Tiranë	6-Nov	2021	Tritol	
53	Jo	Jo	L.Ç.	Tiranë	22.Apr	2019	Tritol		118	Jo	Jo	O.I.	Tiranë	7-Nov	2021	Tritol	
54	Jo	Jo	A.Gj.	Brëshen	06.May	2019	Tritol		119	Jo	Jo	A.H.	Fier	26-Nov	2021	C4	
55	Jo	Jo	Textile Factory	Vlorë	04.Jun	2019	Tritol		120	Jo	1	I.S.	Vlorë	19-Dec	2021	C4	
56	Jo	Jo	A.T.	Lushnje	06.Jun	2019	Tritol		121	Jo	Jo	?	Tiranë	20-Dec	2021	?	
57	Jo	Jo	Greek Memorial	Delvinë	23.Jul	2019	Tritol		122	1	Jo	E.R.	Elbasan	30-Dec	2021	Tritol	
58	Jo	Jo	?	Tiranë	26.Jul	2019	Tritol		123	Jo	Jo	B.S.	Vlorë	3-Jan	2022	Tritol	
59	Jo	Jo	V.D.	Tiranë	05.Aug	2019	Tritol		124	Jo	Jo	V.K.	Vlorë	5-Jan	2022	Tritol	
60	Jo	Jo	T.K.	Lezhë	08.Aug	2019	Tritol		125	Jo	2	M.H. S.D.	Tiranë	7-Jan	2022	Tritol	
61	Jo	Jo	ATMBank	Kavajë	26-Aug	2019	Tritol		126	Jo	Jo	N.S.	Krujë	21-Jan	2022	Tritol	
62	Jo	Jo	APFamily	Fushë-Krujë	2-Oct	2019	Tritol		127	Jo	Jo	A.D.	Durrës	24-Jan	2022	Tritol	
63	Jo	Jo	A.B.	Tiranë	18-Oct	2019	Tritol		128	Jo	Jo	A.Xh.	Pogradec	14-Mar	2022	Tritol	
64	Jo	Jo	G.K.	Dibër	8-Nov	2019	Tritol		129	Jo	Jo	Xh.B.	Shkodër	26-Mar	2022	Tritol	
65	Jo	Jo	F.T.	Gjrokastër	20-Nov	2019	Tritol		130	Jo	Jo	Lici Family	Shkodër	26-Mar	2022	Tritol	
									131	Jo	Jo	?	Lezhë	1-Apr	2022	Tritol	

Nr	Viktima		Objektivi	Vendi	Data	Viti	Lloji eksplozivitet	Niveli i dëmit	Nr	Viktima		Objektivi	Vendi	Data	Viti	Lloji eksplozivitet	Niveli i dëmit
	Vdekje	Plagosje								Vdekje	Plagosje						
132	Jo	Jo	H. G.	Durres	23-Apr	2022	Tritol		145	Jo	Jo	R. H.	Mat	2-Aug	2022	Tritol	
133	Jo	Jo	N. Y.	Sarande	24-Apr	2022	Tritol		146	Jo	Jo	A. A.	Tiranë	10-Aug	2022	Tritol	
134	Jo	Jo	N. Rr.	Shkodër	20-May	2022	Tritol		147	Jo	Jo	M. Z.	Tiranë	10-Aug	2022	Tritol	
135	Jo	Jo	E. K.	Vlorë	30-May	2022	Tritol		148	Jo	Jo	R. P.	Tiranë	24-Aug	2022	Tritol	
136	Jo	Jo	A. Ll.	Kamëz	31-May	2022	Tritol		149	Jo	Jo	A. K.	Krujë	28-Aug	2022	Tritol	
137	Jo	Jo	P. V.	Shkodër	2-Jun	2022	Tritol		150	Jo	Jo	B. L.	Tiranë	1-Oct	2022	Tritol	
138	Jo	Jo	R. R.	Durres	8-Jun	2022	Tritol		151	Jo	Jo	Z. K.	Lezhë	15-Oct	2022	Tritol	
139	Jo	Jo	L. M.	Kavajë	8-Jun	2022	Tritol		152	Jo	Jo	E. P.	Tiranë	19-Oct	2022	Tritol	
140	1	Jo	A. S.	Tiranë	11-Jun	2022	Tritol		153	Jo	Jo	B. Ç.	Lushnje	2-Nov	2022	Tritol	
141	Jo	Jo	Sh. A.	Durres	19-Jun	2022	Tritol		154	Jo	Jo	M. B.	Fushë-Krujë	2-Nov	2022	Tritol	
142	Jo	Jo	M. M.	Sarande	29-Jun	2022	Tritol		155	Jo	Jo	Dh. K.	Përrenjas	19-Nov	2022	Tritol	
143	Jo	Jo	T. M.	Lezhë	1-Jul	2022	Tritol		156	Jo	Jo	J. K.	Durrës	26-Nov	2022	Tritol	
144	Jo	Jo	R. P.	Tiranë	28-Jul	2022	Tritol		157	Jo	Jo	L. L.	Sarande	5-Dec	2022	Tritol	

Shtojca 2: Eksplozivat e kapura në Shqipëri (01.05.2017 – 10.12.2022)

Nr	Personat e implizuar	Krahë	Pjesë të impliku	Vendi	Data	Lloji eksploziv të kapur	Numri i eksploziv	Drogë e kapur		Armatim Kapur		Operacioni policisë	
								Po/Jo	Lloji	Po/Jo	Lloji	Oper i planizu	Emri operacionit
1	2	F.Ç. S.K.	1	Lezhë	10/05/17	Mina me telekom	3	Jo	-	Jo	-	Po	Etalon
2	2	N.R. M.H.	Jo	Elbasan	13/07/17	Mina me telekom	3	Jo	-	Jo	-	Po	Specialisti
3	2	J.M. E.K.	Jo	Tirana	12/03/17	Mina me telekom	3	Jo	-	Jo	-	Po	Explosion
4	1	E.D.	Jo	Pogradec	12/11/17	Tritol	1	Jo	-	Jo	-	Jo	-
5	1	R.H.	Jo	Vlora	17/01/18	Mina me telekom	2	Jo	-	Jo	-	Po	Packages
6	2	A.P. V.C.	2	Lezhë	21/02/18	Mina me telekom	3	Po	Kanabis	Jo	-	Po	Goes On
7	1	F.LI	Jo	Kurbin	10/05/18	Mina me telekom	2	Jo	-	Jo	-	Po	Skuter
8	1	E.S.	Jo	Lezhë	23/06/18	Mina me telekom	6	Jo	-	Jo	-	Po	Udhëtimi
9	?	?	Jo	Burrel	24/06/18	Time charge	1	Jo	-	Jo	-	Jo	-
10	1	A.K.	1	Durrës	01/07/18	Tritol	4	Jo	-	Jo	-	Jo	-
11	1	Gj.P.	Jo	Vlora	15/03/18	Tritol and Grenade	8 pako Tritol, 1 Grenade	Po	Kanabis	Po	1Pistol	Po	Maskimi
12	1	F.L.	Jo	Kukës	24/03/18	Tritol	1	Po	Kanabis	Jo	-	?	-
13	4	E.V.	3	Lezhë	30/03/18	Mina me sahat	4	Po	Kanabis	Jo	-	Po	Telekomanda
14	1	P.K.	Jo	Elbasan	20/10/18	Mina me telekom	4	Jo	-	Jo	-	Po	Mengel
15	1	F.L.	Jo	Tirana	24/10/18	Tritol	14	Jo	-	Jo	-	Jo	-
16	3	K.G.	2	Tirana	02/11/18	Tritol	17	Po	Kanabis	Po	1pushke	Po	Ndëshkimi të fonteve
17	1	F.K.	Jo	Tirana	11/11/18	Tritol	8 packs (x150gr), 1grenade.	Jo	-	Jo	-	Jo	-
18	2	A.B. H.Gj.	Jo	Kukës	07/12/18	Mina me telekom	3	Jo	-	Jo	-	Po	Muzgu
19	1	A.N.	Jo	Lezhë	15/12/18	Mina me telekom	4	Po	Heroine (130 gr)	Jo	-	Po	Trotyl
20	1	?	Jo	Elbasan	04/02/19	Mina me telekom	1	Po	Kanabis	Jo	-	Po	Zaranika
21	1	?	Jo	Vlora	31/03/19	Mina me telekom	1	Jo	-	Jo	-	Jo	-
22	2	?	Po	Lezhë	01/04/19	Mina me telekom	3	Po	Kanabis (3.2 kg)	Jo	-	Po	The Long Way
23	1	?	Jo	Bulqizë	04/04/19	Grenade	1	Jo	-	Jo	-	Jo	-
24	1	K.P.	Jo	Vlora	08/04/19	Mina me telekom	1	Jo	-	Jo	-	Jo	-
25	1	?	Jo	Elbasan	27/07/19	Grenata	27	Jo	-	Jo	-	Jo	-
26	1	?	Jo	Elbasan	13/08/19	Tritol	1.6Kg	Jo	-	Po	13Pistols 400 fisheke	Po	Paper
27	1	P. Th.	Jo	Korce	30/08/19	pajisje plasese	1	Jo	-	Po	Pushke& fisheke	Po	-
28	2	T.B. S.B.	Jo	Vlora	16/10/19	Tritol	Disapako	Po	Kanabis 10kg	Po	4Kallac, 1pistol	Po	Selenica
29	1	P.D.	Jo	Lezhë	06/12/19	Grenade	1	Po	?	Jo	-	Jo	-
30	1	?	Jo	Permet	10/01/20	Tritol	1	Jo	-	Jo	-	Jo	-
31	2	?	Jo	Shkodër	16/02/20	Tritol	1	Jo	-	Jo	-	Jo	-
32	1	?	Jo	Kurbin	13/05/20	Tritol	Disapako	Po	Kanabis	Po	Municion	Po	Shemia
33	1	?	Jo	Vlora	04/06/20	Tritol	1	Jo	-	Jo	-	Jo	-
34	?	?	Jo	Vlora	11/06/20	Tritol	1	Jo	-	Jo	-	Jo	-
35	1	R.V.	Jo	Elbasan	12/06/20	Grenade	1	Jo	-	Jo	-	Jo	-
36	2	?	Jo	Tirana	18/06/20	Tritol, Hand grenades	10 Tritol, 10 Grenates	Jo	-	Po	1mitraloz; 7Kallac; 3pistols; 2MP7s; 1 sniper; 1 shotgun	Po	Yisheku
37	?	A.B.	Po	Krujë	13/07/20	Tritol	1	Jo	-	Jo	-	Jo	-
38	1	L.Zh.	Jo	Elbasan	24/03/20	Tritol	6	Jo	-	Po	1Kallac	Jo	-

36 Persons identified and arrested in total